



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1082 / Prot. 114

Gjirokastrë, më 08 / 08 / 2020

**STRATEGJIA PER KËRKIMIN SHKENCOR NË
UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ"
(2020-2025)**



(Miratuar me Vendimin nr. 26, datë 08/08 / 2020, të Senatit Akademik të UGJ-së

Parathënie

Strategjia për Kërkimin Shkencor përbën një dokument të rëndësishëm programatik të UGJ-së.

Hartimi saj është realizuar në përputhje me objektivat e Ugj-së për nxitjen dhe mbështetjen e Kërkimit shkencor, duke pasur parasysh rolin që ai luan përmes risive dhe përparimeve teknologjike në dobi të rrijës së cilësisë së Arsimit të lartë dhe zhvillimit socio-ekonomik.

Strategjia përcakton vizionin, qëllimet dhe objektivat strategjike të zhvillimit të kërkimit shkencor në UGJ gjatë periudhës (2020-2025). Prioritet strategjike të përcaktuara në këtë dokument janë pjesë e Strategjisë së Zhvillimit të UGJ-së (2020-2025).

Universiteti "Eqrem Çabej", si çdo universitet publik shqiptar, krahas misionit të tij të parë, atë *të edukimit*, përpiqet të realizojë më sukses misionin e *kërkimit shkencor* si dhe misionin e tretë atë të *bashkëpunimit me sektorët publikë e privat të rajonit*, përmes transfertës së teknologjisë së informacionit, edukimit të vazhdueshëm dhe angazhimit social. *Kërkimi shkencor përbën një nga pikat kyçe të strategjisë së zhvillimit të UGJ-së.*

UGJ si një institucion i arsimit të lartë kryen veprimtari kërkimore-shkencore bazë dhe të zbatuar, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese sipas objektivave specifike të institucionit. Ugj garanton integrimin e veprimtarisë kërkimore në atë të edukimit. Veprimtaria kërkimore-shkencore që kryhen në UGJ synon të mbështesë rritjen e cilësisë së edukimit, zhvillimin rajonal, kombëtar, etj.

Organizimi I dokumentit të strategjisë.

Dokumenti I strategjisë është organizuar në pesë pjesë kryesore.

Pjesa I. KORNIZA LIGJORE DHE KONTEKTI EKZEKUTIV

Në këtë pjesë trajtohet kuadri ligjor dhe sfondi ekzekutiv për kërkimin shkencor në UGJ.

Pjesa II. VIZIONI QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Në këtë pjesë trajtohen vizioni I UGJ-së për guqizimin e kërkimit shkencor për të përballuar me sukses sfidat e arsimit të lartë dhe të zhvillimit rajonal e kombëtar. Gjithashtu në këtë pjesë paraqiten objektivat, produktet dhe aktivitetet që parashikon UGJ lidhur me prioritetet e kërkimit shkencor



Pjesa III. BURIMET FINANCIARE

Në këtë pjesë paraqiten burimet financiare për zbatimin dhe bashkërendimin e strategjisë .

Pjesa IV. INFRASTRUKTURA NË MBËSHTETJE TË KËRKIMI SHKENCOR

Në pjesën e katërt trajtohet infrastruktura që mbështet veprimtarinë kërkimore shkencore në UGJ.

Pjesa V. PLANIFIKIMI, MONITORIMI, PUBLIKIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

Kjo pjesë paraqet procedurat që zbatohen për planifikimin, monitorimin, publikimin dhe analizën (kriteret) vlerësuese të kërkimit shkencor në UGJ.

Pjesa I. KORNIZA LIGJORE DHE KONTEKTI EKZEKUTIV


▪ Korniza ligjore për Kërkimin Shkencor

Aktiviteti kërkimor shkencor në UGJ, organizohet dhe zhvillohet në zbatim të ligjit Nr.80 / 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” Neni 40 pika 3, Neni 93 “Kërkimi Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë”, mbështetur në politikat mbi Arsimin e lartë të ndjekura nga MASR, në Statutin e Universitetit “Eqrem Cabej” neni 19 pika 1, Strategjitë për Kërkimin Shkencor të Njësive bazë dhe Njësive kryesore.

▪ Konteksti ekzekutiv për Kërkimin Shkencor

UGJ është themeluar në vitin 1969, dhe përbëhet nga 3 Njësi kryesore dhe 12 Njësi bazë. Gjatë dekadave të fundit, UGJ ka pasur ndryshime pozitive në lidhje me strukturën, fokusin dhe objektivat e kërkimit-shkencor. Sipas Ligjit Nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe Statutin të UGJ-së, kërkimi kryhet nga Njësitë Bazë (grupet mësimore-kërkimore shkencore përkatëse) e koordinuar nga zyra e Zv/Dekanit për Kërkimin shkencor në nivel Njësie kryesore, ndërsa në nivel universiteti puna kërkimore koordinohet nga Zv/Rektori për Kërkimin shkencor mbështetur nga sektori i Kërkimit shkencor dhe Marrëdhënieve me jashtë.

Zv/Rektori për Kërkimin shkencor: harton në bashkëpunim me Njësitë bazë dhe kryesore, kalendarin vjetor të veprimtarive shkencore dhe ndjek zbatimin e tij; krijon bazën e të dhënave për kërkimin shkencor në UGJ duke e përditësuar; paraqet për miratim në Senatin akademik projekte kërkimore shkencore; raporton përgjatë dhe në fund të çdo viti akademik veprimtarinë kërkimore-shkencore pranë Senatit akademik, ku dhe kryhen dhe vlerësimet përkatëse.



Pjesa II. VIZIONI QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

▪ **Vizioni:**

UGJ synon të :

- jetë një qëndër rajonale e edukimit dhe kërkimit shkencor;
- kthehet një qëndër e rëndësishme referimi rajonal e kombëtare në kooperimin akademik universitar,
- kërkimin shkencor, aktivitetin botues, dhe promovimin e vlerave të arsimit të lartë;
- rrisë cilësinë e kërkimit duke e orientuar me fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit (referuar Ligjit Nr.80 / 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” *Neni 12, pika 2*).
- organizojë dhe ofrojë diploma të përbashkëta me universitetet partnere, në kuadrin e marrëveshjeve dhe programeve të studimit me interes të përbashkët, etj.

▪ **Qëllimet:**

- Të përcaktojë objektivat e kërkimit shkencor, fushta prioritare në bashkërendim me Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit në fushat e shkencave natyrore, teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane (AKKSHI), Politikat Sektoriale të Zhvillimit, të cilat zbatohen nëpërmjet projekteve të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik dhe novativ.
- Të hartojë një politikë efektive kërkimore fokusuar në ngritjen dhe funksionimin e mekanizmave të brendshëm financiarë dhe stimujve për punën kërkimore-shkencore;
- Të forcojë lidhjet e bashkëpunimit ndërkufitar në fushën e kërkimit shkencor.
- Të rrisë bashkëpunimin mes komunitetit të kërkuesve dhe atij të biznesit.
- Të pregatisë Raportin vjetor të institucionit për Kërkimin shkencor, etj

Objektivat:

1. të ngrihet Qendra kërkimore-shkencore e universitetit dhe Qendra studimore ndërdisiplinore.



2. të nxisë dhe mbështesë kualifikimin dhe veprimtarinë botuese të stafit akademik (artikuj, tekste mësimore, monografi, revieë, etj), duke shfrytëzuar bashkëpunimin me IAL kombëtare dhe ndërkombëtare;
3. të promovojë zhvillimin e mësimin në distancë;
4. të ngrejë dhe organizojë infrastrukturën bazë dhe të domosdoshmë në funksion të ciklit të tretë të studimeve(shkollës së doktoraturës);
5. të rrisë investimet për infrastrukturën e kërkimit shkencor dhe efektivitetin të përdorimit të saj.
6. të nxisë krijimin e një gjenerate të re kërkuesish shkencorë në fushat e politikave sociale, mjedisore dhe ekonomike.
7. të zgjerojë bashkëpunimin ndërkombëtare, për më shumë mundësi trajnimi, mbështetje në pajisje dhe laboratore;
8. “Ndërkombëtarizimin e programeve të studimit” dhe shqyrtimin e mundësive për krijimin dhe realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me universitete të huaja partnere;
9. të krijojë mekanizmat ligjorë për financimin e kërkimit shkencor nga biznesi;
10. të nxisë pjesëmarrjen e biznesit në realizimin e projekteve në fusha të përbashkëta interesi etj.

▪ **Fushat kryesore të kërkimit**

Në planin strategjik parashikohen fushat konkrete prioritare, si më poshtë:

- a. Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- b. Metodatat e edukimit në distancë;
- c. Zhvillimi historik dhe linguistik (*probleme të dygjuhësisë*);
- d. Sistemet dhe teknologjitë e informacionit
- e. Biodiversiteti dhe Mjedisi;
- f. Zhvillimet demografike;
- g. Turizmi rual etj.

Pjesa III. BURIMET FINANCIARE

Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe aplikative është pjesë integrale e buxhetit të UGJ-së për çdo vit akademik. UGJ harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të Njësive kryesore dhe të



Njësisive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij. Kërkesa për financimin e programit vjetor të kërkimit shkencor bazë dhe të aplikuar nga buxheti i shtetit, bëhet nga njësitë kryesore në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.

Financimi i kërkimit shkencor realizohet me të ardhurat e vetë institucionit, donacione dhe burime të tjera të ligjshme si dhe nga granti i punës kërkimore shkencore që shpërndahet nga AKKSHI mbi bazën e konkurimit të projekteve. Universiteti "Eqrem Çabej" përcjell pranë AKKSHI çdo projekt shkencor të ardhur nga njësitë bazë të tij pas vleresimit paraprak nga ana e Rektoratit.

UGJ-ja kryen shërbime për të tretë si ekspertiza, analiza, këshillime, monitorime, shërbime informacioni etj. Këto veprimtari kryhen me financime të palëve të interesuara. Të ardhurat nga këto veprimtari shkojnë në favor të UGJ-së.

Pjesa IV. INFRASTRUKTURA NË MBËSHTETJE TË KËRKIMI SHKENCOR

UGJ ka ngritur dhe përmirëson në vazhdimësi infrastrukturën në mbështetje dhe funksion të veprimtarisë kërkimore shkencor.

Biblioteka ka një fond të madh të **Titujve shkencorë** (në shqip dhe në gjuhë të huaj), **Revista Shkencore**, **Monografi Shkencore**, etj. Krahas bibliotekës qëndrore, universitetit posedon dhe vë në shërbim të hulumtimit shkencor dy **bibliotekat: një në gjuhë greke dhe një në gjuhë italiane**. Biblioteka vë në shërbim: sistemin dixhital të katalogimit COBISS; burimet elektronike të siteve shkencore (Net, Ebsco), si dhe U-Library.

Në funksion dhe shërbim të kërkimit në UGJ është **Infrastruktura laboratorike** : laborator Didaktik dhe kerkimor i Italishtes; Laboratori Didaktik dhe Kërkimor i Gjeografisë; Laboratori i Arkeologjisë; Informatikës; Fizikës; Infermierisë; Biologjisë, etj.

- **Veprimtaria kërkimore-shkencore** në UGJ rezulton si:
 - veprimtari kërkimore-shkencore në funksion të kualifikimit për grada e titujt.
 - aktivitet botues: artikuj, monografi, tekste universitare dhe parauniversitare, recenca shkencore, etj.
 - referime në Kongrese apo Konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, etj.
 - udhëheqje e temave të diplomës në Master shkencor dhe Doktoraturë.
 - pjesëmarrje në projekte, etj.



Pjesa V. PLANIFIKIMI, MONITORIMI, PUBLIKIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

- **Planifikimi.** Departamentet dhe grupet e kërkimit shkencor fillimisht mbështetur në ndiskutimet dhe propozimet e anëtarëve të saj, përcaktojnë fushat bazë, duke orientuar prioritetet e institucionit në fushën e kërkimit shkencor, në përputhshmëri me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Anëtarët e departamentit cdo vit paraqesin planin e punës kërkimore shkencore pranë përgjegjësit të Njesisë bazë ose drejtuesit të grupit mësimit-kërkimor.

- **Monitorimi.** Njësia bazë monitoron rregullisht ecurinë e punës kërkimore shkencore të grupeve kërkimore shkencore krahas nxitjes, bashkërendimit, organizimit të kësaj veprimtarie. Një monitorim kryhet në distance nga Zv/Dekani për kërkimin shkencor në nivel fakulteti dhe nga Zv/Rektori për kërkimin shkencor në nivel universiteti.

- **Publikimi.** Në zbatim të ligjit Nr.80 / 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” *Neni 94*, Ugj ka detyrimin të bëjë publike veprimtarinë kërkimore-shkencore si edhe rezultatet përkatëse. Publikimi i rezultateve të veprimtarisë kërkimore në UGJ bëhet në forma të ndryshme: në organin e vet Buletini shkencor “Kërkime universitare” (ndërkombëtarisht i verifikueshëm), vëllime me përmbledhje të referimeve, kumtesave të mbajtura në kuadër të një veprimtarie shkencore (simpoziumi, konferencë, kongresi etj).

Vlerësimi i rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. Referuar Statutit *Neni 14*, UGJ ka ngritur mekanizma për vlerësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të personelit akademik. Performanca e punës kërkimore e të gjitha llojeve e niveleve vlerësohet nga Njësitë bazë (grupet kërkimore brenda tyre), Njësitë kryesore të UGJ-së si dhe nga Senati Akademik. Njësitë bazë (përgjegjësit), organizojnë analiza periodike dhe vjetore për realizimin e detyrave të punës shkencore referuar planifikimeve vjetore të secilit anëtar. Në bashkëpunim me strukturat ndihmëse (njësitë bazë dhe kryesore), Zëvendësrektori për shkencën dhe marrëdhëniet me jashtë përgatit raportin vjetor të veprimtarisë kërkimore të universitetit dhe ja paraqet Rektoratit për miratim dhe më pas Senatit Akademik. Raporti vjetor analizon realizimin e objektivave në terma sasiorë dhe cilësorë, ku evidentohen dhe shkaqet e mosrealizimit. Ai përbën instrumentin kryesor të vlerësimit të: numrit të publikimeve në revista kombëtare dhe ndërkombëtare me IF ose pa IF:



monografive; pjesëmarrjes në konferenca apo kongrese si referues (me bashkëautor nga universitetet e vendeve të tjera), moderator, drejtues shkencor, numrit të revieë-ve dhe citimeve (MCR); numri I projekteve në fushën e kërkimit shkencore, përfshirjes në programet e mobilitetit etj.

Procesi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë realizohet çdo katër vjet nga AKKSHI, në përputhje me kriteret. Kriteri bibliometrik, impaktit të kërkimit shkencor, infrastrukturale, kapaciteteve njerëzore dhe ndërkombëtarizimit. Vlerësimi për çdo tregues që përbën kriteret e vlerësimit, në nivel njësive bazë, realizohet nëpërmjet një sistemi pikëzimi algoritmik, në mënyrë automatike nga platforma elektronike, Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor-ACRIS.

Gjithashtu UGJ ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, duke organizuar simpoziume, konferenca shkencore, seminare dhe duke krijuar në këtë mënyrë një traditë.

Garantimi i aksesit për transferimin e informacionit mbi rezultatet, produktet e të gjithë llojeve të veprimtarisë së kërkimit shkencor në UGJ realizohet nëpërmjet platformës online me akses të hapur dhe përditësimit të saj.

